



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punës dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 72

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

Prishtinë, më 5 qershor 2013, në orën 13:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Flora Brovina, Bahri Thaçi, Salihe Mustafa, Gezim Kelmendi, Nazane Breca, Liburn Aliu

Munguan: Sasha Gjokiq.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj, administratore e Komisionit, Xheneta Sopjani, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 22.05.2013
3. Shqyrtimi i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti
4. Shqyrtimi i Projektligjit për transplantimin e organeve
5. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 22.05.2013

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin nga mbledhja e datës 22.05.2013

3. Shqyrtimi i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti

Fikrim Damka – Si jeni te njoftuar ne kemi përfunduar më herët amendamentimin e Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti, por pas rekomandimeve të Komisionit për Buxhet si grup punues kemi ndryshuar disa amendamente, prandaj sot do ti votojmë ato amendamente të ndryshuara dhe do ti dërgojmë edhe një herë te Komisionet kryesore.

Amendamenti 1

Në nenin 3, paragrafi 1.7. riformulohet si vijo :

1.7. **“Pensioni i parakohshëm”** - nënkupton pensionin e rregullt mujor të paguar për të punësuarit e kompleksit “Trepça”, dhe të punësuarit në minierat e tjera të Kosovës, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë Ligj.

Amendamenti 2

Në nenin 6, fshihet fjala,, do të garantoj “ dhe zëvendësohet me „, garanton” .

Amendamenti 3

Në nenin 7, paragrafi 2.2. fshihet fjala „, se banon “ dhe zëvendësohet me „, është banorë i përhershëm”.

Amendamenti 4

Në nenin 8, paragrafin 1 , pas fjalës „, person” shtohet fjalia „, të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe “.

Amendamenti 5

Në nenin 8, paragrafi 2, në fund të paragrafit pas fjalës „nxjerr” shtohet fjalia „, brenda një (1) viti “

Amendamenti 6

Në nenin 8 , pas paragrafit 5, shtohet paragrafi i ri si vijon :

E drejta dhe përcaktimi i kushteve dhe kriterëve për pension kontributpagues të moshës për punëtorët e Kosovës të larguar me dhunë nga puna , apo të shpallur si tepriçë teknologjike pa bazë ligjore , në vitet 1989 deri 1999, do të rregullohet me akt të veçantë ligjor apo nënligjor.

Amendamenti 7

Në nenin 9 , paragrafi 5.1. fshihet fjalia,, për një apo më shumë vjet ‘’.

Amendamenti 8

Në nenin 9, paragrafi 6, pas fjalës „ zyrtarët’’ shtohet fjala „ përgjegjës’’ dhe fshihet fjala „ aftësisë së kufizuar ‘’ dhe zëvendësohet me „ paaftësisë së përhershme’’.

Amendamenti 9

Në nenin 10, paragrafi 1, riformulohet si vijon :

1. Të drejtën për pension të parakohshëm e realizojnë të gjithë të punësuarit në kompleksin “Trepça” dhe në minierat e tjera të Kosovës, të cilët kanë humbur vendin e punës deri në fund të vitit 2004.

Amendamenti 10

Në nenin 10, paragrafi 2, pjesa e parë riformulohet si vijon :

2. Pensionet e parakohshme do t’ju paguhen të gjithë të punësuarve të kompleksit “Trepça” dhe punëtorëve të tjerë të punësuar në minierat e Kosovës, nëse:

Amendamenti 11

Në nenin 10, paragrafin 2.4. fjala „ në miniera ‘’ zëvendësohet me „ në kompleksin Trepça apo në minierat tjera të Kosovës ‘’.

Amendamenti 12

Në nenin 10, paragrafi 2.7. fjalia „ aftësia e punës të jetë zvogëluar së paku për 50%’’ zëvendësohet me „shkalla e invaliditetit të jetë mbi 50%’’.

Amendamenti 13

Në nenin 12 , paragrafi 4.1 fshihet fjalia „ prej moshës 55 vjeçare’’ dhe në paragrafin 4.2. fshihet fjalia,, 55 deri në’’.

Amendamenti 14

Në nenin 12, paragrafi 6 , fshihet fjala „ një apo më shumë ” dhe shtohet fjala „ secilin ‘’.

Amendamenti 15

Në nenin 12, paragrafin 7, fshihet fjala „ prej 70% ‘’ dhe ne fund të paragrafit shtohet fjalia „ dhe duke përfshi rritjen prej 20% sipas paragrafit 6 të këtij neni’’.

Amendamenti 16

Neni 15, dhe 16 fshihen dhe riformulohen në një nen si vijon :

Neni 15 Beneficionet Subjekt i Vështirësive Fiskale

Në rast të jostabilitet financiar dhe me qëllim të ruajtjes së disiplinës fiskale publike, zbatohet neni 36 i Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe neni 4 i Ligjit nr.04/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Amendamenti 17

Neni 22, të riformulohet si vijon :

1. Pagesat e pensionit bazik të moshës dhe i aftësisë së kufizuar të përcaktuara me këtë Ligj, do të ndërpriten, si në rastet e mëposhtme:

1.1. Në rast të vdekjes së pensionistit, pagesa e pensionit ndërpritet në muajin pasues pas vdekjes së tij/saj;

1.2. Në rast se përfituesi i pensionit bazik të moshës dhe i aftësisë së kufizuar, fiton nënshetësinë e shtetit, me të cilin Republika e Kosovës, nuk ka Marrëveshje Bilaterale për sigurime sociale;

1.3. Nëse vlerësohet se parashtruesi i kërkesës ka bërë mashtrim apo keqinterpretim gjatë procesit të aplikimit ose gjatë monitorimit dhe inspektimit nga zyrtarët përgjegjës të Ministrisë, konstatohen prova materiale të rrejshme nga ana e pensionistit.

2. Pagesa e pensioneve për shfrytëzuesit e pensioneve kontributpaguese të përcaktuara me këtë Ligj, do të ndërpriten, si në rastet e mëposhtme:

2.1. Në rast të vdekjes së pensionistit, pagesa e pensionit ndërpritet në muajin pasues pas vdekjes së tij/saj;

2.2. Nëse vlerësohet se parashtruesi i kërkesës ka bërë mashtrim apo keqinterpretim gjatë procesit të aplikimit ose gjatë monitorimit dhe inspektimit nga zyrtarët përgjegjës të Ministrisë, konstatohen prova materiale të rrejshme nga ana e pensionistit.

Amendamenti 18

Në nenin 23, paragrafi 2, në fund të paragrafit shtohet fjalia „apo kujdestarit ligjor “.

Amendamenti 19

Në nenin 25, pas paragrafit 4, shtohet paragraf i ri 5, si vijon :

5. Me rastin e vdekjes së pensionistit, familja përfiton 3(tri) pensione, me kusht që vdekjen e pensionistit ta lajmërojnë brenda 30 ditësh nga dita e vdekjes së pensionistit.

Amendamenti 20

Në nenin 31, fshihet „01.01.2016” dhe zëvendësohet me „01.01.2015”.

Komisioni, me dy abstenime për amendamentin 6 , dhe me 1 votë kundër Projektligjit , miratoj amendamentet në Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për transplantimin e organeve

Fikrim Damka – Tha se grupi punues ka përfunduar amendamentet , të votojmë me radhë:

Amendamenti 1

Në nenin 3, paragrafi 1.1. pas fjalës „ i vdekur “ shtohet fjalia „dhe vendosja te personi tjetër “ dhe në fund të paragrafit fshihet fjalia „ Transplantimin e indeve dhe qelizave”.

Amendamenti 2

Në nenin 3, paragrafi 1.7. fshihet fjala „(donori)” , në paragrafin 1.8. fshihet fjala „ (recipienti)”, në paragrafin 1.9. fshihet fjala „donimi” dhe në paragrafin 1.15, fjala „ identifikimi “ zëvendësohet me fjalën „ gjurmimi”.

Amendamenti 3

Në nenin 3 , paragrafi 1.24. të fshihet .

Amendamenti 4

Në nenin 3, pas paragrafit 1.26. shtohen dy paragrafë si vijon:

1.27. **Banka e organeve** , është institucion apo strukturë shëndetësore e licencuar nga Ministria e Shëndetësisë në varësi të QSHTK-së, që kryen veprimtari shëndetësor si: konservimin, ruajtjen, etiketimin, paketimin, ekzaminim, përpunimin, si dhe shpërndarjen e organeve apo pjesëve të organeve të destinuara për transplantim, përfshirë dokumentimin e të dhënave për to.

1.28. **Laborator për tipizim** , është institucion shëndetësor publik apo privat , i pavarur apo në kuadër të Qendrës për transplantim, apo Bankës së organeve , i destinuar për kryerjen e të gjitha analizave nga fushveprimtaria e vet.

Amendamenti 5

Në titullin e nenit 7 , fshihet fjala „ **vullnetar**”

Amendamenti 6

Në nenin 10, paragrafi 1 , fjala„ e drejte” zëvendësohet me „ e barabartë”.

Amendamenti 7

Në nenin 24 , paragrafi 1 , fshihet fjalia „ nga paragrafi 1 i këtij neni e “

Amendamenti 8

Në nenin 25, paragrafi 1, kalon si titull i nenit.

Amendamenti 9

Në nenin 27, paragrafi 2, fshihet fjalia „ i limituar në Kosovë”.

Amendamenti 10

Në nenin 28 , paragrafi 3 , riformulohet si vijon :

QSHTK, udhëhiqet nga drejtori , i cili duhet te këtë eksperiencë në fushën e transplantimeve dhe zgjidhet nga Ministri i Shëndetësisë.

Amendamenti 11

Në nenin 28 , paragrafi 4 , riformulohet si vijon :

4. QSHTK ka një bord profesional prej 7 anëtarësh . Anëtarët e bordit të QSHTK zgjidhen nga Ministria e Shëndetësisë me konkurs publik dhe duhet të kryejnë detyrat e QSHTK, sipas paragrafit 2 , të këtij neni.

Amendamenti 12

Në nenin 29, paragrafi 4, fshihet fjala „ Të gjitha” dhe në paragrafin 4.1 „ të “ zëvendësohet me „ në”

Amendamenti 13

Në nenin 29, paragrafi 4.8 riformulohet si vijon :

4.8. Të dhënat i ruajnë në anonimitet, në mënyrë të tillë që si dhuruesi ashtu edhe përfituesi të mos identifikohen;

Amendamenti 14

Në nenin 29 pas paragrafit 4.12. shtohet paragraf i ri si vijon :

4.13. E drejta e hapjes së qendrave për transplantim të organeve ju lejohet vetëm institucioneve shëndetësore publike.

Amendamenti 15

Në nenin 30, paragrafi 5.1. fjala „ Bankave të “ zëvendësohet me „ Bankës së “ dhe në tërë tekstin e Projektligjit fjala „bankat” zëvendësohet me „banka” .

Amendamenti 16

Në nenin 34, paragrafin 2.2. fjala „ urdhëresë “ zëvendësohet me „ pëlqimin” dhe gjithashtu fjala „ emëruar” zëvendësohet me „ autorizuar”.

Amendamenti 17

Në nenin 42 , paragrafi 1 , kalon si titull i nenit, dhe vazhdon renditja e paragrafëve .

Amendamenti 18

Në nenin 44 dhe 45 , fjala „ donorëve” zëvendësohet me fjalën „ dhuruesve”.

Amendamenti 19

Në nenin 46, paragrafi 1.1. riformulohet si vijon „ Posedon pëlqimin e shkruar të personit të vdekur, apo kartelën e dhuruesit”.

Amendamenti 20

Në nenin 46 , paragrafi 1.2. fshihet fjala „ Respektivisht kur “ dhe në paragrafin 1.3. fshihet fjala „ Me këtë rast “ .

Amendamenti 21

Titulli i nenit 47 riformulohet si vijon „ E drejta për respekt “

Amendamenti 22

Në nenin 49 , paragrafi 1 , fjala „ kriteriumeve “ zëvendësohet me fjalën „ kriterëve “.

Amendamenti 23

Titulli i nenin 50, riformulohet si vijon „ **Dhuruesit potencial** “ dhe në paragrafin 1, fjala „ ose pa kufizim moshor në rastin e dhuruesit të vdekur “ zëvendësohet me „ dhe pa kufizim moshe të dhuruesit e vdekur”.

Amendamenti 24

Në nenin 50 , paragrafi 3.1. ndahet në dy paragraf si vijon :

3.1. Bashkëshortët , që në martesë janë së paku për 3 vite .

3.2. Partneri jashtë martesor, që në këtë marrëdhënie janë se bashku për një periudhë të paktën 5 vjeçare, në bazë të dëshmive përkatëse.

Amendamenti 25

Në nenin 50 , pas paragrafit 3.2. shtohet paragraf i ri si vijon :

3.3. Shtetasi i huaj i cili duhet të kaloj në procedurën e verifikimit për afërsinë familjare me marrësin.

Amendamenti 26

Në nenin 53, paragrafi 4, pas fjalës „ gjallë” shtohet fjala „ edhe”.

Amendamenti 27

Në nenin 58 , paragrafi 8 , fshihet fjala „këto “

Amendamenti 28

Në nenin 58, paragrafët 8.2. dhe 8.3. , kalojnë pas paragrafit 8.6.

Amendamenti 29

Në nenin 58, paragrafi 11, fshihet fjala „ publike ‘’.

Amendamenti 30

Në nenin 59, paragrafi 2, fshihet „, apo ‘’.

Amendamenti 31

Në nenin 61, paragrafi 1.4. pas fjalës „, organeve ‘’ shtohet „,në’’.

Amendamenti 32

Në nenin 61, paragrafi 2 , në fund të paragrafit shtohet fjala „, publike’’.

Amendamenti 33

Në kreun VIII , të fshihet fjala „administrative’’, dhe neni 62, të titullohet „, Sanksionet administrative ‘’.

Amendamenti 34

Në nenin 62, paragrafi 2.5. në fund të paragrafit „, 3 vjet ‘’ zëvendësohet me „, 5 vjet’’

Amendamenti 35

Në nenin 62, paragrafi 5 , në fund të paragrafit shtohen fjalët „, përkatësisht Ministria e Shëndetësisë’’.

Amendamenti 36

Në nenin 62, pas paragrafit 6, shtohet paragraf i ri si vijon :

7. Ministria e shëndetësisë nxjerr akt nënligjor për specifikimin e shkeljeve administrative.

Amendamenti 37

Kreu IX , me nenet, 63, 64, 65 dhe 66, fshihen dhe zëvendësohen me një nen si vijon :

Neni 63

Veprat penale

Shkeljet që përbëjnë vepër penal , dënohen sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës .

Amendamenti 38

Para nenit 67 , shtohet një nen i ri si vijon :

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ministria e Shëndetësisë, në afat prej gjashtë (6) muajsh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të nxjerrë aktet nënligjore të parapara më këtë ligji .

Amendamenti 39

Të fshihen fjalët „ **KALIMTARE DHE**“

Komisioni ,njëzëri miratoj amendamentet në Projektligjin për transplantimin e organeve.

6. Të ndryshme

Në piken të ndryshme Komisioni vendosi që me 12 qershor 2013 , në orën 11:00, të mbahet dëgjim publik për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, personave të dhunuar gjatë luftës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka